



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.5242/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-048 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkorja Buxhetore 2025/01 me Nr. 1259/2024 e datës 15.05.2024, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 65, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 27.06.2024 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITET 2025-2027

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2025-2027 e cila përmban planifikimet nga financimet qeveritare dhe nga të hyrat vetanake të komunës për vitin 2025-2027. Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, planifikimi i buxhetit për vitin 2026 është në shumë prej 3,789,234.00 €, planifikimi i buxhetit për vitin 2027 është në shumë prej 3,967,100.00 €.
2. Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2025-2027 përmban qëllimin, objektivat parashikimet për vitet vijuese dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Ky vendim iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorëve të Drejtorive,
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve – Departamentit të Buxhetit,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.06.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





01/Nr. 5243 /2024

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, neni 3, paragrafi 1.33, 1.44, neni 16 paragrafi 1, Ligjit Nr. 03L/-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, paragrafi 30.2, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.06.2024 merr këtë:

VENDIM
PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE PASURI
JOFINANCIARE

1. Kuvendi i Komunës miratoi kërkesën me nr.04/5243/2024 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për rialokim të mjeteve në kategorinë Pasuri Jofinanciare
2. Rialokimi i mjeteve në kategorinë Pasuri Jofinanciare është në shumë prej **74,646.35 €**, ku nga fondi (10) në shumë prej 59,646.35 € dhe nga fondi (21) në shumë prej 15,000.00 €.

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë Pasuri Jofinanciare, burimi i financimit (10 dhe 21),

Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620).

Rialokohen nga projektet:

- “Mjete të lira për bashkinvestime”, kodi (41641) shuma prej 10,000.00 €, fondi burimor (10),
- “Ndërtimi i mbikalimeve në Rr. Martirët Bushi dhe Rr. Lepenci”, kodi (53429), në shumë prej 30,000.00 €, nga fondi burimor (10) në shumë prej 15,000.00 € dhe 15,000.00 € nga fondi burimor (21),
- “Rregulimi i hapësirave publike (me kubëza betoni dhe gjelbërim) në rr.Dëshmorët e Kombit, Isa Berisha në Han të Elezit dhe rr.Gafur Loku-fsh.Paldenicë”, kodi (55043), në shumë prej 12,000.00 €, fondi burimor (10).
- “Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri, Stadiumi i qytetit - Suad Brava- Shpronësim kodi (53902), në shumë prej 22,646.35 €, nga fondi burimor (10).

Rialokohen në projektet:

- “Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 - Hani i Elezit”, kodi (55037), në shumë prej 18,531.00 €, mjetet merren nga fondi (10).
- “Asfaltimi i rrugës "Nehat Curri", lagja Curri - Dromjak”, kodi (55048), në shumë prej 39,115.35 €, merren nga fondi (10).
- “Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik.”, kodi (53484), në shumë prej 2,000.00 €, mjetet merren nga fondi (10).
- “Ndërtimi i rrugës Nënberg në fshatin Seçishtë”, kodi (55050), në shumë prej 15,000.00 €, mjetet merren nga fondi (21).

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive Komunale,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Data : 27.06.2024
Hani i Elezit





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.5226/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2024 merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025

1. Kuvendi i komunës miratoi propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.

2. Grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:

1. Florim Shkreta - PDK
2. Xhevahir Dernjani -PDK
3. Sherif Berisha -LVV
4. Hyrijete Isufi - LDK
5. Nora Xhoni- AAK

3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e grupit punues,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.06.2024

